

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**TRANSKRIPTI
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 27.4.2007**

**TRANSKRIPT
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE DANA 27.04.2007.GODINE**

PRILL - APRIL 2007

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 13 prillit 2007,
3. Koha për pyetje të deputetëve,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse dhe
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kimikatet.

DNEVNI RED

1. Usvajanje dnevno redi,
2. Usvajanje zapisniksa sa plenarnih sednica od 13 aprila 2007.godine,
3. Vreme za poslanička pitanja,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakokna o sprečavanju zaraznih bolesti,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o hemikalijama,

AGENDA

1. Approval of the agenda,
2. Approval of the plenary session minutes on 13 April 2007,
3. Time for deputies question,
4. Second reading of the Draft Law on Prevention of infected disease and,
5. Second reading of the Draft Law on chemicals.

Seanca plenare u mbajt në sallën e Kuvendit të Kosovës

Seancën e kryesoi Xhavit Haliti
Seanca filloi me punë në orën 10,15

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Të nderuar deputetë. Mirë se keni ardhur në seancën e sotme të Kuvendit të Kosovës.

Ju njoftoj që në sallë janë të pranishëm 86 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar me punët.

Njëkohësisht dua t'ju informoj lidhur me rendin e ditës që ka pësuar pak ndryshime me kërkesë të Qeverisë. Komisioni Fakt Mbledhës i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ka takime me Qeverinë dhe kryeministri ka kërkuar që çështja e pyetjeve - pika e rendit të ditës me pyetje të shtyhet për një seancë të ardhshme. Prandaj, mendoj që do ta bëjmë një miratim formal, sepse kështu e kemi situatën.

Konstatojmë që miratohet shtyrja e pikës së 3 të rendit të ditës për seancën e ardhshme.

Njëkohësisht dua t'ju përkujtoj që nga Kuvendi i Kosovës, dita e 27 prillit është shpallur si ditë e të pagjeturëve, e martirëve të pagjetur në Kosovë dhe shoqatat të cilat kanë kërkuar që kjo ditë të shënohet kanë dërguar një falimnderim për miratimin e këtij vendimi. Njëkohësisht dua t'ju njoftoj që sot në fshatin Meje bëhet varrosja e 20 martirëve. Në pamundësi që deputetët e Parlamentit të Kosovës të marrin pjesë në varrimin e tyre, ju ftoj që të mbajmë një minutë heshtje.

(Lavdi)

Rendin e ditës e keni marrë . Ju kisha lutur që nëse ka vërejtje dikush për rendin e ditës ta marrë fjalën.

Për rendin e ditës e ka kërkuar fjalën Fatmire Mulhaxha – Kollqaku.

FATMIRE MULHAXHA – KOLLQAKU – Faleminderit z. kryesues. Në emër të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale , propozoj që pika e 4 e rendit të ditës të shtyhet për seancën e parë të radhës, për shkak të disa lëshimeve teknike që i kemi vërejt do të thotë dhe kjo është arsyeja pse ne po propozojmë të shtyhet, sepse duhet shumë kohë të merret për t'i arsyetuar ato lëshime teknike sot.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Kërkesa është në emër të Komisionit. Dikush tjetër. Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI – Faleminderit. I nderuari kryesues, të nderuar deputetë. Shtroj pyetjen pasi që është miratimi i rendit të ditës: Cilat janë shkaqet dhe arsyet që nuk është vu në rend të ditës formalizimi në seancën plenare i Grupit Parlamentar të LDD-së? Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Zoti deputeti Gjergj Dedaj.